



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725, [URL:http://www.umib.net](http://www.umib.net), Mail:rektorati@umib.net

BUXHETI PËR VITIN 2018
VLERËSIMET PËR VITET 2019/2020

Tetor 2017

Bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH)2018/2020,Qarkoret Buxhetore 2018/01 dhe 2018/02 lidhur me caktimin e kufijve final për buxhetin e vitin 2018 dhe nenit 180 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës mbi procedurat buxhetore, rektori i Universitetit të Mitrovicës paraqet për aprovim buxhetin për vitin 2018 të bazuar në kufijtë final për vitin 2018 dhe parashikimet për vitet 2019/2020

HYRJE

Buxheti i UMIB-it i bazuar në kufijtë final të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë është harmonizuar dhe është i bazuar në dokumentet:

1. Korniza Afatmesme të Shpenzimeve Buxhetore 2018-2020 të lëshuar nga Ministria e Financave
2. Korniza Afatmesme të Shpenzimeve Buxhetore 2018-2020 të hartuar nga UMIB-i
3. Qarkorja e parë 2018/01 dhe të dytë 2018/02 mbi përcaktimin e kufijve final të lëshuar nga Ministria e Financave
4. Kufijtë fillestar dhe final të përcaktuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
5. Aktivitetet të bazuar në funksionalizim të objektit të ri universitar-KAMPUSI


Buxheti për Universitetin e Mitrovicës për vitin 2018 i bazuar në Qarkoren e dytë buxhetore nr. 2018/02 për kufijtë final është 2.905.5398.00 euro që në krahasim me buxhetin e vitit 2017 është me i lartë për 166.699.56 euro ose me indeks të rritjes për 6.09%.

Struktura e buxhetit gjegjësisht pjesëmarrja e buxhetit nëpër kategori ekonomike ndryshon nga viti fiskal 2017.

Në kategorinë ekonomike paga dhe mëditje kemi rritje për 199.999.56 euro ose me indeks prej 10.86%,shpenzimet komunale janë ngritë për 165.000.00 euro ose me indeks prej 330%,subvencionet për 20.000.00 ose me indeks 200% në krahasim me vitin 2017. Buxheti i planifikuar për investime kapitale është zvogëluar për 218.500.00 ose me indeks prej 57.98% .Buxheti për kategoritë tjera është në nivel të planifikuarës të vitit 2017.

Buxheti për vitin 2018 i strukturuar sipas kategorive ekonomike dhe burimeve të financimit

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti final për vitin fiskal 2017	Burimet e financimit	
			Buxheti i Kosovës	Të hyrat vetanake
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.042.359.00	1.927.698.00	114.661.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	316.339.00	316.339.00	
3.	SHPENZIME KOMUNALE	215.200.00	215.200.00	
4.	SUBVENCIONE	30.000.00	30.000.00	
5.	INVESTIME KAPITALE	301.500.00	301.500.00	
6.	GJITHSEJ	2.905.398.00	2.790.737.00	114.661.00



VLERËSIMET E BUXHETIT PËR VITET FISKALE 2019/2020

	KATEGORIA EKONOMIKE	Buxheti final për vitin fiskal 2019	Buxheti final për vitin fiskal 2020
1.	PAGA DHE MËDITJE	2.142.359.00	2.292.359.00
2.	MALLRA DHE SHËRBIME	316.339.00	316.339.00
3.	SHPENZIME KOMUNALE	50.000.00	50.000.00
4.	SUBVENCIONE	30.000.00	30.000.00
5.	INVESTIME KAPITALE	1.050.000.00	1.050.000.00
6.	GJITHSEJ	3.588.698.00	3.738.698.00

Vitin fiskal/buxhetor për Universitetin e Mitrovicës 2018 planifikohet të jetë vit i sfidave me faktin se janë planifikuar ose do të jenë në finalizim shumë aktivitete të cilat ndërlidhen me mjete financiare dhe kufijtë e përcaktuar buxhetor për të gjitha kategoritë ekonomike. Rezultatet e planifikuara në masë të madhe do të varen nga qasja e realizimit të kërkesave për buxhet shtesë të drejtuara institucioneve relevante për kategoritë ekonomike: paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione dhe transfere.

Sfiduese edhe në këtë vit do të jetë mungesa e buxhetit për kategorinë paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime gjithnjë duke konsideruar vitin e ri akademik 2017/2018 i cila ndërlidhet edhe me finalizim e procesit të ri-akreditimit të programeve të njësive akademike dhe inaugurimi, funksionalizimi dhe mirëmbajtja e objektit të ri universitar/Kampusit.

- Sfidat e planifikuara për vitin fiskal 2018
- Mungesa e mjeteve për mbulimin e obligimeve në kategorinë paga dhe mëditje
 1. Reflektimi i mungesës së mjeteve për paga në implementimin e programit për planin e personelit akademik dhe administrativ të lejuar sipas numrit të planifikuar në Ligjin mbi Buxhetin për UMIB.
- Mungesa e mjeteve në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime
 1. Inventarizimi i Kampusit të ri universitar sipas projektit
 2. Sigurimi dhe shërbimet për mirëmbajtje të Kampusit
 3. Pajisja e laboratorëve me kemikate dhe pjesë të tjera të imta në funksion të procesit.
 4. Pajisja e sallave për lexim me kompjuter dhe pajisje tjera të teknologjisë informative.
 5. Funksionalizimi dhe mirëmbajtja e objektit të ri/Kampusit

Analiza e buxhetit sipas kategorive ekonomike

PAGA DHE MËDITJE.

Masa buxhetore për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje për vitin 2018 është 2.042.359.00 që në krahasim me vitin 2017 shënon një rritje të lehtë prej 10.86% ose për 199.999.56 euro.

Masa e rritur buxhetore nuk është në lidhmëni të drejtë me numrin e planifikuar të punëtorëve (196) të lejuar sipas Ligjit mbi Buxhetin. Mjetet e planifikuara mbulojnë vetëm 135 të punësuar (87 personel akademik dhe 48 personel administrativ) duke pamundësuar që të plotësohen edhe 61 vende të lira të planifikuara sipas kufijve final të përcaktuara në qarkoren e dytë buxhetore nr 2018/02 (196-135=61). Bazuar në buxhetin e planifikuar sipas qarkores së parë 2018/02 UMIB është në minus prej 728.194.33 euro.

Pasqyrë e pagës së planifikuar bazuar në kufijtëfinal (qarkorja 2018/02)

Personeli I UMIB-it	nr.i planifikuar	baza	shuma	shtesa vendime	mbi norma	pervoja e punes	gjithsej	5%	paga mujore	paga ne vit
prof.rregullt	30	1429.54	42886.2	6660	8674	6382.93	64603.13	3230.157	67833.2865	813999.438
prof.i asoc.	11	1283.84	14122.24	280	500	2168.84	17071.08	853.554	17924.634	215095.608
prof.asistent	20	1137.17	22743.4	530	1100	2472.38	26845.78	1342.289	28188.069	338256.828
asistent	21	772.5	16222.5	210	3000	509.29	19941.79	997.0895	20938.8795	251266.554
asistent I ri	1	698	698			41.93	739.93	36.9965	776.9265	9323.118
lektor	1	884.74	884.74			71.8	956.54	47.827	1004.367	12052.404
ligjerues	3	990.94	2972.82		416	455	3843.82	192.191	4036.011	48432.132
sekretar	1	1429.54	1429.54			200.14	1629.68	81.484	1711.164	20533.968
Udhëheqës	8	768.75	6150	250		561.75	6961.75	348.0875	7309.8375	87718.05
Sekretar.fak	2	768.75	1537.5			95	1632.5	81.625	1714.125	20569.5
Per. adm-nistrative 1	5	500	2500			250	2750	137.5	2887.5	34650
Per. adm-nistrative 2	8	500	4000			230	4230	211.5	4441.5	53298
Per. adm-nistrative 3	22	438	9636			420	10056	502.8	10558.8	126705.6
Personel teknik	2	385	770			60	830	41.5	871.5	10458
	135		126552.94	7930	13690	13919.1	162092	8104.6	170196.6	2042359.2

Pasqyrë e pagës së planifikuar bazuar në numrin e lejuar prej 196 të punësuar(qarkorja 2018/01)

Personeli I UMIB-it	Nr. Staf it	baza	Shuma e pages bazë	5 % e pagës bazë	Shtesat me vendime të vecanta/mbi norma	5 % e shtesave	Pervoja e pune	5% pervoja ne pune	Total
Rektor	1	1429.54	17,154.48	857.72	12,000.00	600.00	1,368.00	68.40	32,048.60
Prorektor	3	1429.54	51,463.44	2,573.17	31,800.00	1,590.00	5,916.00	295.80	93,638.41
Anët.i KD	2		-	-	5,400.00	270.00	-	-	5,670.00
Anëtar.i KD	5	1429.54	85,772.40	4,288.62	86,294.88	4,314.74	13,638.00	681.90	194,990.54
Sekretar	1	1429.54	17,154.48	857.72	-	-	2,401.68	120.08	20,533.97

Dekan	6	1429.54	102,926.88	5,146.34	48,888.00	2,444.40	9,169.68	458.48	169,033.79
Prodekan	6	1429.54	102,926.88	5,146.34	37,805.28	1,890.26	8,491.44	424.57	156,684.78
Prof.i regullt	19	1429.54	325,935.12	16,296.76	13,680.00	684.00	35,338.56	1,766.93	393,701.36
Prof.i asoc	16	1,283.34	246,401.28	12,320.06	9,360.00	468.00	26,452.08	1,322.60	296,324.03
Lektor	1	884.74	10,616.88	530.84	1,761.68	88.08	810.96	40.55	13,849.00
Prof.asistent	34	1,137.14	463,953.12	23,197.66	21,409.20	1,070.46	33,600.00	1,680.00	544,910.44
Ligjerues	3	990.94	35,673.84	1,783.69	3,792.00	189.60	3,091.92	154.60	44,685.65
asistent	33	772.50	305,910.00	15,295.50	10,140.00	507.00	6,600.00	330.00	338,782.50
Asistent I ri	1	698.50	8,382.00	419.10	-	-	503.16	25.16	9,329.42
Udheheqës	8	768.75	73,800.00	3,690.00	3,000.00	150.00	6,738.60	336.93	87,715.53
Sekretar në fakultete	6	466.25	33,570.00	1,678.50	21,744.00	1,087.20	600.00	30.00	58,709.70
Pers. administrative 1	17	487.50	99,450.00	4,972.50	1,500.00	75.00	1,518.24	75.91	107,591.65
Pers. administrative 2	10	348.75	41,850.00	2,092.50	14,538.74	726.94	3,000.00	150.00	62,358.18
Pers. administrative 3	23	277.50	76,590.00	3,829.50	44,286.74	2,214.34	5,403.60	270.18	132,594.36
Personel teknik	1	232.50	2,790.00	139.50	3,672.00	183.60	587.16	29.36	7,401.62
	196		2,102,320.80	105,116.04	371,072.53	18,553.63	165,229.08	8,261.45	2,770,553.53

Sfidat për vitin 2018

- Mungesa e mjeteve buxhetore për përmbushjen e obligimeve për personelin e rregullt akademik ,të angazhuar dhe personelin administrativ aktual.
- Finalizimi i implementimit të programit/planit për rekrutim të personelit administrativ dhe akademik.
- Mungesa e mjeteve për plotësimin e 61 vendeve të lira bazuar në strukturën e planifikuar të punëtorëve
- Vështirësitë financiare në përmbushjen e obligimeve për personelin akademik të avancuar.

MALLRA DHE SHËRBIME

Masa buxhetore e planifikuar për vitin 2018 për kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime është 316.339.00 euro. Mjetet e ndara në krahasim me buxhetin e vitit 2017 nuk kanë pësuar ndryshime. Realizimi i objektivave dhe aktiviteteve në masë të madhe do të jetë e kushtëzuar nga buxheti, prandaj menaxhmenti duhet të hartoi programin për racionalizim të shpenzimeve duke përcaktuar qartë prioritet. Kërkesat për buxhet shtesë për mbulimin e shpenzimeve të planifikuara duhet të drejtohen tek të gjitha institucionet por mundësisht edhe donatorëve me qëllim të funksionalizimit dhe mbarëvajtjes së procesit për sigurim dhe mirëmbajtje të objektit të ri universitar.

Implementimi i rekomandimeve të FMN-së për racionalizim të shpenzimeve për këtë kategori dhe zvogëlimi në kontinuitet i masës buxhetore do të ndikon në realizimin e shumë aktiviteteve për Universitetin e Mitrovicës.

Situatën e vështirë financiare për këtë kategori do të rëndon edhe më shumë finalizimi dhe hapja e KAMPUSIT të ri universitar në Mitrovicë që planifikohet të inaugurohet në vitin 2017. Funkcionalizimi dhe mirëmbajtja e objektit prej 17.000 m² dhe sipërfaqës prej 13 ha parashtrohet edhe kërkesën për buxhet shtesë. Mjetet shtesë do të jenë të nevojshme për furnizim /pajisje me inventar, sigurim dhe mirëmbajtje të objektit, teknologji informative, ngrohje qendrore dhe shumë shpenzime tjera që ndërlidhen me funksionalizimin e objektit. Mos aprovimi i kërkesës do të vështirësonte funksionimin e universitetit dhe prolongimin e hapjes së Kampusit të ri universitar që konsiderohet si një ndër objekt më standarde në rajon. Kampusi i ri është i pajisur edhe me hapësira për laboratorë që do të jenë në funksion të njërive akademike-teknike që pretendojnë të jenë të teknologjisë së kohës dhe që janë në raport të drejtë me kërkesat e tregut të punës. Universiteti i Mitrovicës është i njohur dhe ka traditë për fakultetet teknike dhe të gjeologjisë por edhe në vizionin e Ministrit të Arsimit është potencuar që përparësi do të kenë fushat të cilat kanë kërkesa të tregut të punës në përgjithësi. Prandaj KD dhe menaxhmenti prioritet do të kenë që laboratorët të pajisen me pajisje që do t'ju shërbejnë studentëve dhe do të përgatiten kuadro të reja për tregun e punës. Buxheti është i pa mjaftuar për mbulimin e shpenzimeve prandaj është e domosdoshme buxhet shtesë për të funksionalizuar laboratorët të cilat janë të ndërtuara sipas standardeve të Bashkësisë Evropiane.

SHPENZIMET KOMUNALE

Masa buxhetore për këtë kategori në krahasim me buxhetin e vitit 2017 nuk ka pësuar ndryshime. Për vitin fiskal janë planifikuar 50.000.00 euro që as për së afërmi nuk i përmbushin shpenzimet e planifikuara. Mirëmbajtja e kampusit të ri universitar parashtrohet kërkesën për buxhet shtesë sidomos për mbulimin e shpenzimeve për ngrohje qendrore dhe energji elektrike. Sipas parashikimeve nevojiten edhe 175.000.00 euro për të mbuluar shpenzimet e planifikuara. Mungesa e mjeteve do të vështirëson mbarëvajtjen dhe funksionalizimin e objektit të ri universitar.

SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

Stimulimi i studentëve të dalluar, organizimi dhe këmbimi i përvojave të studentëve gjatë udhëtimeve studimore në masë të madhe varet nga mjetet të cilat planifikohen për këtë kategori. Përkundër kërkesave pothuajse të të gjitha Universiteteve publike për rritje të mjeteve për këtë kategori prapë se prapë masa buxhetore ka mbetë e njëjtë dhe atë 10.000.00 euro. Masa e planifikuar buxhetore do të jetë sfidë për menaxhmentin se si të gjendet mënyra e stimulimit dhe shpenzimit të mjeteve në mënyrë që mjetet mos të kthehen si të pashfrytëzuara në Buxhetin e Kosovës.

INVESTIME KAPITALE

Buxheti i planifikuar për vitin 2018 në krahasim me mjetet e planifikuara të vitit 2017 janë më të ulëta për 298.500.00 euro ose me indeks prej 50.25% .

I tërë buxheti i planifikuar është ndarë për pajisjen e laboratorëve dhe hapësira me teknologji informative e cila do të jetë në funksion të funksionimit të laboratorëve dhe hapësirave të Kampusit.

Nr.	KATEGORIA EKONOMIKE	Projektet e planifikuara	SHUMA
1	Investime kapitale		301.500.00
		Ndërtimi dhe rregullimi i infrastrukturës	30.000.00
		Furnizimi me pajisje të teknologjisë infomative	30.000.00
		Për furnizim dhe pajisje të laboratorëve për FIMK	100.000.00
		Për furnizim dhe pajisje të laboratorëve për FTU	81.500.00
		Për furnizim dhe pajisje të laboratorëve për FGJ	60.000.00

TË HYRAT VETANAKE

Të hyrat vetanake janë në nivelin e planifikimit të vitit të kaluar fiskal. Për vitin buxhetor 2018 janë planifikuara 114.661.00 euro që do të grumbullohen nga shërbimet e ofruara për student. Të gjitha mjetet e planifikuara do të dedikohen për përmbushjen e obligimeve për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje dhe nuk mund të përdoren për qëllime tjera.

Në tabelën e poshtëshënuar është pasqyruar struktura e të hyrave vetanake për shërbimet e ofruara

nr	EMËRTIMI I TË HYRAVE VETANAKE	TOTALI
1	Vërtetim për certificate te notave	1.499.00
2	Vërtetim për diplomë	1.030.00
3	Mbrojtje të diplomave master	900.00
4	Paraqitje të provimeve- master	4.902.00
5	Provim pranues	6.310.00
6	Për secilin provim të pranuar me rastin e tranferit	785.00
7	Për ndërrim fakulteti/departamenti	750.00
8	Regjistrimin e semestrit te rregullt-bachelor	55.350.00
9	Regjistrimin e semestrit te rregullt-master	43.135.00
10	gjithsej	114.661.00